



2016

	NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE STACIONI I AUTOBUSAVE SH.A. JAVNO LOKALNO PREDUZEĆE AUTOBUSKA STANICA D.D. PUBLIC ENTERPRISE LOCAL BUS STATION J.S.C.	
Nr. <u>02/32</u>	Date <u>25.01</u> 20 <u>16</u>	
No. _____	Date _____	
PRISHTINË/A		

RREGULLORE E KOMISIONIT TË AUDITIMIT
"NPL" STACIONI I AUTOBUSËVE" Sh.A. PRISHTINË



Përmbajtja

1. QËLLIMI
2. AUTORITETI
3. PËRBËRJA DHE THEMELIMI I KOMITETIT TË AUDITIMIT
4. MBLEDHJET / TAKIMET
5. Pjesëmarrja në mbledhje / takime nga zyrtarët e tjerë
6. QASJA NË KOMITETIN E AUDITIMIT
7. RAPORTIMI
8. PËRGJEGJËSITË DHE KOMPETENCATE KOMISIONIT TË AUDITIMIT
9. PASQYRAT FINANCIARE
10. RISHIQIMI I PASQYRAVE FINANCIARE DHE QËSHTJEVE TJERA.
11. PAJTUESHMËRIA
12. KONTROLLI I BRENDSHËM
13. MENAXHIMI I RREZIKUT
14. KOMITETI I AUDITIMIT KARSHI FUNKSIONIMIT TË AUDITORIT TË BRENDSHËM NË NDËRMARRJE
15. PERFORMANCA E AUDITORËVE TË BRENDSHËM DHE TË JASHTËM
16. KËRKESAT PËR INFORMACIONE PËR KOMITETIN E AUDITIMIT
17. TË TJERA

HYRJE

Ky model i rregullores së Komisionit të Auditimit bazohet në Ligjin për Ndërmarrjet Publike (03/L-087), Ligji Nr. 04/L-111 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike dhe në përputhje me parimet e njohura ndërkombetare të qeverisjes korporative për ndërmarrjet publike.

Kjo rregullore nuk mund të përmbledh të gjitha aktivitetet që do të mund të ishin adekuate për një komision të caktuar të auditimit, e as aktivitetet e inkorporuara në këtë rregullore nuk do të jenë relevante për komisionet tjera, prandaj kjo rregullore do të përshtatet NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë.

1. Qëllimi

Për të përkrahur ndërmarrjen në afarizmin e vet, për të përkrahur qeverisjen lokale të Kuvendit Komunal të Prishtinës (aksionarin apo organet relevante) në adresimin e përgjegjësive të tyre për rrezikun, kontrollin dhe qeverisjen, dhe aktivitetet e ndërlidhura. Në mënyrë specifike, kjo përfshinë asistimin e përfaqësuesit të Kuvendit Komunal të Prishtinës apo aksionarin në përmbushjen e përgjegjësive të tyre për:

- Integritetin dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare
- Pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullatore
- Kontrollin e brendshëm të financave
- Menaxhimin e rrezikut
- Efikasitetin dhe objektivitetin e funksioneve të auditimit të brendshëm dhe
- Performancën e funksionit të auditimit të brendshëm dhe auditorëve të jashtëm.

2. AUTORITETI

Ligji për ndërmarrjet Publike dhe Ligji për Shoqëritë Tregtare I jep autoritetin dhe përgjegjësinë komisionit të auditimit që të:

- 2.1. Sigurojnë se menaxhmenti i lartë dhe personeli i ndërmarrjes zbatojnë me kohë rekomandimet e bëra nga auditori I brendshëm.
- 2.2. Kërkojnë apo lejojnë që auditori i brendshëm të vlerësojë shkallën deri në të cilën janë zbatuar rekomandimet e mëparshme dhe shkallën e ndonjë përmirësimi që ka rezultuar në bazë të rekomandimeve.
- 2.3. Raportojnë të gjitha instancat e ndonjë dyshimi për shkelje ligjore tek autoritetet publike përkatëse.
- 2.4. Sigurojnë që auditori i brendshëm është i pavarur dhe i lirë nga ndërhyrja e menaxhmentit të operacioneve të cilat auditohen.
- 2.5. Sigurojnë dhe përpilojnë deklaratën e kompenzimit të zyrtarëve ashtu siq është e përcaktuar me Ligj.
- 2.6. Hetojnë ndonjë ndërhyrje të pretenduar, refuzim apo rezistim të aktiviteteve të ligjshme të auditimit të brendshëm dhe përnjëherë të ndreqin atë sjellje duke përfshirë:
 - 2.6.1. *Suspendimin, largimin apo marrjen e veprimeve të tjera disiplinore ndaj personit në fjalë.*
 - 2.6.2. *Kërkojnë që auditori I brendshëm të dorëzojë planet e auditimit për miratim*
 - 2.6.3. *Mbajnë të gjitha dokumentet në lidhje me secilin auditim, sikur edhe ndonjë auditim të suspenduar.*
 - 2.6.4. *Komisioni i Auditimit në bazë të kërkesave për ndonjë qështje të caktuar i propozon bordit të drejtorëve për miratim të propozimit për formimin e ndonjë grupi punues për ndërtimin e metodave të reja dhe standardizimin e operimeve në përgjithësi të ndërmarrjes apo hulumtimeve, këshillimeve etj.*

- 2.6.5. Po që se është e nevojshme dhe kur kërkohet informatë shtesë apo këshillim, komisioni i auditimit ka të drejtë të fton persona të tjerë të kualifikuar brenda, apo jashtë ndërmarrjes për të ofruar përvojën e tyre në bazë të nevojave dhe kërkesave të komisionit të auditimit, gjithmonë duke u bazuar në Ligjin për ndërmarrjet Publike.
- 2.6.6. Format e kompenzimit për anëtarin këshillues nga brenda dhe jashtë apo grupe të punës për qështje të caktuara të ndërmarrjes, komisioni i auditimit i deklaron ato me deklaratë të veqantë të kompemnzimit të tyre, gjithmonë duke u bazuar në miratimin e vendimit të bordit të drejtorëve të ndërmarrjes.

3. PËRBËRJA DHE THEMELIMI I KOMISIONIT TË AUDITIMIT

- Ç'do Komision i Auditimit do të përbëhet nga tre (3) drejtorë të zgjedhur. Komisioni i Auditimit caktohet nga Aksionari (ët). Komisioni i auditimit dhe Kryesuesi i Komisionit të auditimit zgjedhet nga Komisioni i Aksionarit. Së paku dy (2) anëtarë të caktuar në këtë mënyrë duhet të jenë drejtorë, të cilët janë ekspert, ose së paku kanë njohuri adekuate në kontabilitet. Anëtari i tretë do të jetë një drejtor tjetër, përveç KE-së ose kryesuesit.

3.1. Ashtu siq është e përcaktuar me Ligj asnjëri anëtar i komitetit të auditimit nuk do të jetë anëtar i ekipës ekzekutuese të ndërmarrjes.

3.2. Përshtatshmëria profesionale a anëtarëve të komisionit të auditimit duhet të jetë në përputhje me profesionet e fushave të ndryshme, të kontabilitetit, në auditim, dhe administratë publike, dhe siq është e përcaktuar me Ligjin për ndërmarrjet Publike.

✚ Komisioni Auditimit i NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë është në përbërje prej:

- Dëfrim Byqmeti, kryesues i komitetit të auditimit (drejtor i bordit të drejtorëve të NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A, Prishtinë .
- Flamur Zeqiri, anëtar i komitetit të auditimit (drejtor i bordit të drejtorëve të NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A, Prishtinë.
- Naim Neziri anëtar i komitetit të auditimit (drejtor i bordit të drejtorëve të NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A, Prishtinë.

4. MBLEDHJET / TAKIMET

- 4.1. Komisioni i Auditimit do të takohen më së paku katër (4) herë në vit
- 4.2. Mbledhjet thirren nga kryesuesi i komisionit të auditimit
- 4.3. Kryesuesi i komisionit të Auditimit mund të thërras mbledhje shtesë sipas nevojës.
- 4.4. Kryesisht të gjitha mbledhjet / takimet, do të mbahen në lokalet e ndërmarrjes, dhe në raste të ndryshme edhe jashtë hapësirave të ndërmarrjes po që se është e nevojshme.
- 4.5. Shumica e numrit të pergjithshëm të anëtarëve të komisionit e perbejne kuorumin dhe shumica e kuoromit është e nevojshme për çdo rekomandim apo veprim tjetër të komisionit. Të gjitha vendimet dhe veprimet e tjera të komisionit i nënshtrohen rishikimit, ndryshimit dhe miratimit e jo me pak se 2/3 e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.
- 4.6. Komisioni do të tentoj që të vendosë në mënyre unanime, në rast të mospajtitimit të mendimeve, do të vendos bazuar në shumicën e thjeshtë të votave. Në rast të mungesës së një anëtari dhe barazimit të votave, vota e Kryesuesit të Komisionit do të jetë vendimtare. Në rast se ndonjëri nga anëtarët e Komisionit duhet të abstenojë nga votimi pasi ka shpalosur konflikt interesash, vota e tij nuk do të përfshihet në numërim.
- 4.7. Shërbimet e sekretarisë do të ofrohen kryesisht nga sekretari i ndërmarrjes në raste të caktuara kur komiteti e përcakton konfidenciale një qështje. Gjatë mbledhjes, Kryesuesi i Komisionit të Auditimit, duke vepruar në pajtueshmëri me Ligjin e NP dhe Statutin e ndërmarrjes, duhet të përcaktojë praninë e kuoromit , të drejtojë debatin, si dhe të përcaktojë dhe deklaroj rezultatet e votimit. Proceverbalet do të mbahen nga sekretari i ndërmarrjes në raste të caktuara nga njëri anëtar respektivisht i përcaktuar nga kryesuesi i komitetit të auditimit.
- 4.8. Të gjitha procesverbalet, vendimet dhe aktivitetet që ndërmerren nga komisioni i auditimit ato duhet të mbahen në formë protokolare dhe evidencë të veqantë në arkivin e sekretarisë apo siq e përcakton komiteti i auditimit.
- 4.9. Të gjitha procesverbalet duhet të mirëmbahen për një periudhë kohore deri në shtatë (7) vjet në njësinë e auditorit të brendshëm.

5. PJESËMARRJA NË MBLEDHJE / TAKIME NGA ZYRTARËT TJERË.

- 5.1. Auditori i brendshëm , Zyrtari Kryesor i Financave dhe Thesarit , Kryeshefi Ekzekutiv , Aksionari, dhe përfaqësuesi i Zyrës së Auditorit Gjeneral mund të ftohen që të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit të Auditimit.
- 5.2. Komiteti i Auditimit mund të ftoj zyrtarë të tjerë të organizatës që të marrin pjesë, që të ndihmojnë me diskutime në ndonjë çështje.
- 5.3. Komiteti i Auditimit mund të kërkoj nga ndonjëri apo nga të gjithë që normalisht ndjekin mbledhjen por që nuk janë anëtarë, të tërhiqen nga mbledhja në çfarëdo kohe që të lehtësojnë diskutimet e hapura për çështjet e caktuara.
- 5.4. Kuvendi Komunal I Prishtinës respektivisht aksionari (njësia për monitorimin e ndërmarrjeve publike MZHE) mund të kërkojnë nga Komisioni i Auditimit që të thërras mbledhje tjera për të diskutuar çështjet e caktuara për të cilat kërkojnë këshilla dhe sqarime nga komisioni

6. RAPORTIMI

- 6.1. Komisioni i Auditimit pas çdo mbledhje, do të raportoj zyrtarisht me shkrim në mbledhjen e radhës së bordit të drejtorëve , për vendimet në emër të komisionit të auditimit dhe rekomandimet apo të gjeturat gjatë auditimit të ndonjë çështje të caktuar , e gjithë kjo do të bëhet për të adresuar çështjet që do të paraqiten gjatë aktiviteteve financiare dhe operuese të ndërmarrjes për sa i përket:
 - a) Cilësisë dhe integritetit të pasqyrave financiare.
 - b) Pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi.
 - c) Performancës dhe pavarësisë të Njesisë për Auditimin e Brendshëm.
- 6.2. Komisioni i Auditimit do të përgatis Raportin Vjetor për Kuvendin Komunal të Prishtinës (aksionarin) ku përshkruhet përbërja e komisionit, përgjegjësitë dhe si kryhen ato, si dhe informatat e tjera relevante, përfshirë edhe rishikimin e nivelit të lartë të efektivitetit dhe përshtatshmërisë si dhe pranueshmërisë së raporteve financiare dhe operuese në ndërmarrje e cila përfshinë:
 - 6.3. Procesin për vlerësimin e rrezikut dhe menaxhimin rrezikut, kontrollin e brendshëm dhe përgjegjësitë
 - 6.4. Politikat e kontabilitetit
 - 6.5. Pasqyrat financiare
 - 6.6. Efikasitetin e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm
 - 6.7. Përgjigjen e menaxhmentit për sa i përket çështjeve të identifikuara nga njësia e auditimit të brendshëm dhe auditori i jashtëm (nëpërmjet të letrës së menaxhmentit)

7. PËRGJEGJËSITË DHE KOMPETENCAT E KOMISIONIT TË AUDITIMIT

Komisioni i Auditimit, me përgjegjësi kolektive do t'i përmbahet Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

7.1. Do t'i shqyrtojë planet afat-gjate strategjike, të investimeve dhe financiare të NP-së

7.2. Së bashku me çfarëdo ndryshim plotësime të tyre – si dhe planin vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor para miratimit të tyre nga Bordi i Drejtorëve në tërësi, si dhe t'i sigurojë këtij të fundit të gjitha vërejtjet ose kundërshtimet të cilat i konsideron të nevojshme.

7.3. Para miratimit nga Bordi i Drejtorëve (i) do të shqyrtojë pasqyrën vjetore të bilancit si dhe deklaratën e fitimeve dhe humbjeve të NP-së si dhe cilat do deklarata tjera financiare që kërkohen me ligj, si dhe raportin vjetor mbi menaxhimin, politikën afariste dhe financiare dhe gjendjen industriale të NP-së; dhe (ii) do t'i dorëzojë Bordit të Drejtorëve një raport mbi përshtatshmërinë, saktësinë, vërtetësinë dhe përputhjen me ligjin të këtyre dokumenteve.

7.4. Rregullisht do të shqyrtojë gjendjen financiare të NP-së dhe kushtet e saj të planifikuara financiare, si dhe do t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;

7.5. Rregullisht do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të kontrolleve të brendshme (duke përfshirë ato financiare), si dhe t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;

7.6. Rregullisht do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim që të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i NP-së, duke përfshirë dokumentacionin financiar, mbahen në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me ligjin, dhe që projekt-deklaratat vjetore financiare të përgatiten në mënyrë të rregullt, dhe t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;

7.7. Rregullisht do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga NP të të gjitha ligjeve të aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe punëve të saj, dhe t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;

7.8. Do të emërojë, shkarkojë dhe zëvendësojë Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm si dhe të përcaktojë kompensimin dhe përfitimet e tij/saj, përcaktim ky që duhet të pasqyrohet në deklaratën e politikës së kompensimit të kërkuar sipas Nenit 20.4;

7.9. Do të sigurojë që zyra e auditimit të brendshëm të organizohet dhe të pajiset me personel në mënyrë të rregullt dhe adekuate, dhe rregullisht do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të kësaj zyre si dhe do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze mbi Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm dhe zyrën e auditimit të brendshëm.

7.10. Do t'i shqyrtojë të gjitha transaksionet me palët e ndërlidhura, t'i autorizojë ato të cilat janë të arsyeshme dhe kushtet e të cilave janë të drejta për ndërmarrjen ose, nëse aplikohen kufizimet e përcaktuara në Nenin 36.1, ta këshillojë Aksionarin(ët) mbi arsyeshmërinë dhe drejtësinë e tyre.

7.11. Do t'i mbajë sekret në mënyrë rigoroze të gjitha raportet jo-anonime të cilat paraqiten nga një punonjës dhe që kanë të bëjnë me pohime për keq bërje nga një drejtor, zyrtar ose punonjës tjetër i NP-së; do të mbrojnë identitetin e cilitdo person i cili mund t'i nënshtrohet ndëshkimit si rezultat i paraqitjes së një raporti të kësaj natyre, dhe gjatë mbrojtjes së çfarëdo informatave përkatëse sekrete – shkurtimisht ta informojë punonjësin i cili ka paraqitur raportin e lartë përmendur mbi përfundimet e hetimit i cili është iniciuar si rezultat i paraqitjes së raportit nga ana e tij dhe kur është e nevojshme, do t'i propozojë Bordit të Drejtorëve masa të cilat mund të jenë të nevojshme për zbatimin e detyrave fiduciare të Zyrtarit për Auditim të Brendshëm.

7.12. Para miratimit nga Bordi i Drejtorëve (i) do të shqyrtojë pasqyrën vjetore të bilancit si dhe deklaratën e fitimeve dhe humbjeve të ndërmarrjes, deklarata të tjera financiare që kërkohen me ligj, si dhe raportin vjetor mbi menaxhimin, politikën afariste dhe financiare dhe gjendjen të ndërmarrjes dhe do t'i dorëzojë Bordit të Drejtorëve një raport mbi përshtatshmërinë, saktësinë, vërtetësinë dhe përputhjen me ligjin të këtyre dokumenteve.

7.13. Komisioni i Auditimit rregullisht do të shqyrtojë gjendjen financiare të NP-së dhe kushtet e saj të planifikuara financiare, si dhe do t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme.

- **Komisioni i Auditimit do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt në:**
- Sistemet dhe procedurat të cilat kanë për qëllim që të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni ndërmarrjes duke përfshirë dokumentacionin financiar, mbahen në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe që projekt-deklaratat vjetore financiare të përgatiten në mënyrë të rregullt dhe t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme.
- Sistemet dhe procedurat të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga ndërmarrja gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe punëve të saj, dhe t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme.

A) Komisioni i Auditimit do të:

- Emërojë, shkarkojë dhe zëvendësojë Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm si dhe të përcaktojë kompensimin dhe përfitimet e tij/saj, përcaktim ky që duhet të pasqyrohet në deklaratën e politikës së kompensimit të kërkuar sipas Nenit 20.4 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.
- Do të sigurojë që zyra e auditimit të brendshëm të organizohet dhe të paiset me personel në mënyrë të rregullt dhe adekuate, dhe rregullisht do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të kësaj zyre si dhe do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze mbi Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm dhe Zyrën e Auditimit të Brendshëm.
- Do t'i mbajë sekret në mënyrë rigoroze të gjitha raportet jo-anonime të cilat paraqiten nga një punonjës dhe që kanë të bëjnë me pohime për keq bërje nga një drejtor, zyrtar ose punonjës tjetër i NP-së; do të mbrojë identitetin e cilitdo person i cili mund t'i nënshtrohet ndëshkimit si rezultat të paraqitjes së një raporti të kësaj natyre; dhe – gjatë mbrojtjes së çfarëdo informate përkatëse sekrete – shkurtimisht ta informojë punonjësin i cili ka paraqitur raportin e lartpërmendur mbi përfundimet e hetimit i cili është iniciuar si rezultat i paraqitjes së raportit nga ana e tij.
- Komisioni i Auditimit është i autorizuar që t'a udhëzojë Zyrtarin për Auditim të Brendshëm që të kryejë detyra dhe veprime të cilat janë në kuadër të kompetencave të Komisionit të Auditimit.
- Komisioni mund të marrë çfarëdo informata lidhur me veprimtarinë dhe punët e ndërmarrjes nga cilitdo zyrtar ose punonjës i ndërmarrjes, të kërkojë këshilla nga profesionistë të pavarur, të prokuruar në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, kurdo që një çështje me arsye kërkon pavarësinë e këtyre këshilltarëve nga zyrtarët ose menaxherët e lartë të ndërmarrjes.
- Komisioni mund të kërkojë mbajtjen e një mbledhje të Bordit të Drejtorëve, dhe të tregojë agjendën e kësaj mbledhjeje.
- Komisioni ka mundësi t'ua parashtrojë çfarëdo çështje që ka të bëjë me ndërmarrjen, gjykatave ose organeve kompetente për zbatimin e ligjit.

9 PASQYRAT FINANCIARE

- 9.1. Ku organizata përgatit pasqyra financiare sipas ligjit, rishikon pasqyrat për kualifikim, dhe aprovim.
- 9.2. Merr parasysh çështjet e rëndësishme të politikave të kontabilitetit dhe raportimit si dhe ndikimin e tyre në deklaratat financiare para se të prezantohen deklaratat para auditorëve të jashtëm dhe administratës tatimore të Kosovës.
- 9.3. Çështjet kyçe që duhet të merren parasysh janë:
- 9.4. Të gjitha transaksionet (komplekse apo të pazakonshme)
- 9.5. Artikuj kontabiliteti me gjykim të lartë
- 9.6. Çështjet kryesore për sa i përket parimeve të kontabilitetit dhe prezantimit të pasqyrave financiare, përfshirë çfarëdo ndërrimi të

- rëndësishëm në zgjedhjen apo aplikimin e politikave të kontabilitetit, dhe
- 9.7. Ndikimin e iniciativave regullatore ose të kontabilitetit, dhe strukturat që janë jashtë bilancit në pasqyrat financiare.

10 . RISHIQIMI I PASQYRAVE FINANCIARE DHE QËSHTJEVE TJERA

- 10.1. Pas auditimit sipas ligjit, komiteti I auditimit e rishikon me menaxhmentin dhe auditorin e brendshëm rezultatin e auditimit, në rast të ndonjë vështirësie apo të gjeturat e mundshme do të përfshihet rishiqimi I aktiviteteve financiare dhe operuese.
- 10.2. Kjo përfshinë rishikimin e çfarëdo kufizimi të në fushën e aktiviteteve të auditimit ose qasjen në informatat e kërkuara, dhe ndonjë mosmarrëveshje të rëndësishme në mes të auditorëve dhe menaxhmentit.
- 10.3. Komisioni i auditimit do ti diskutoj pasqyrat financiare me menaxhmentin dhe Auditorin e brendshëm në rastë të caktuara (investiguese) edhe me ndonjë këshilltarë apo përfaqesuesin e zyrës së auditorit general siç nevojitet për të diskutuar çfarëdo çështje që komiteti ose auditorët besojnë që duhet të diskutohet privatisht.(konfidenciale)
- 10.4. Pas cdo investigimi, këshillimi apo auditimi, komisionii i auditimit raporton në mbledhjen e radhës së bordit të drejtorëve.

11 . PAJTUESHMËRIA

- 11.1. Rishikimi i të gjeturave të auditorëve, mendimet, dhe rekomandimet që kanë të bëjnë me sistemet e organizatës për sigurimin e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret.
- 11.2. Rishikimi i të gjeturave të ekzaminimeve nga ana e agjencive regullatore dhe auditorëve.

12 . KONTROLLI I BRENDSHËM

- 12.1. Komisioni i auditimit duhet të merr parasyshë efikasitetin e mjedisit të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë edhe kontrollin e teknologjisë informative dhe sigurisë.
- 12.2. Kupton fushën e rishikimit të kontrollit të brendshëm nga ana e auditorëve të brendshëm dhe jashtëm dhe siguron raporte mbi të gjeturat dhe rekomandimet e rëndësishme, së bashku me përgjigjet e menaxhmentit.

13 . MENAXHIMI I RREZIKUT

- 13.1. Komisioni i Auditimit do të diskutoj me menaxhmentin politikat kryesore për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut.

14 KOMISIONI I AUDITIMIT KARSHI FUNKSIONIMIT TË AUDITORIT TË BRENDSHËM NË NDËRMARRJE

- 14.1. Rishikon me auditorin e brendshëm dhe kryeshefin ekzekutiv, rregulloret dhe statutin e njësisë së auditimit të brendshëm, raportin me shkrim ose me postë elektronike (Email), për planet strategjike dhe vjetore, aktivitetet, punësimin e personelit dhe strukturën organizative të funksionit të auditimit të brendshëm.
- 14.2. Siguron që nuk ka kufizime apo limitime në aktivitetet e auditimit të brendshëm
- 14.3. Komisioni i auditimit rivlerëson për pajtueshmërinë për emërimin, riemërimin apo zëvendësimin dhe shkarkimin e zyrtarit të auditorit të brendshëm.
- 14.4. Merr parasysh raportin vjetor, të gjeturat dhe rekomandimet dhe përmbledhjen e aktiviteteve aktuale dhe të propozuara të auditimit dhe nivelin e sigurisë që ofron ajo
- 14.5. Të gjitha përmbledhjet mujore vjetore apo siq është e paraparë në strategji të auditimit komisioni i auditimit duhet ti specifikojë ato, ti identifikojë, të rekomandojë po që se nuk janë zbatuar ato në bazë të auditimit të brendshëm apo të jashtëm dhe ti raportojë ato si:
- 14.6. Auditimet speciale ose hetimet e komisionit
- 14.7. Raportimi i mashtrimit potencial apo praktikave të korrupsionit të zyrtarët e ndërmarrjes dhe cdo punonjësi tjetër.

15 . PERFORMANCA E AUDITORËVE TË BRENDSHËM DHE TË JASHTËM.

- 15.1. Rishikimi i fushës së propozuar dhe qasjes së auditorëve të jashtëm, përfshirë koordinimin e përpjekjeve të auditimit me auditimin e brendshëm.
- 15.2. Rishikimi i performancës së auditorëve të jashtëm, duke marrë parasysh mendimet e menaxhmentit dhe Drejtorit, dhe auditorit të brendshëm .
- 15.3. Rishikimi i efikasitetit të auditorit të brendshëm, përfshirë pajtueshmërinë me standardet relevante profesionale dhe duke pasur kujdes ndaj mendimeve të menaxhmentit dhe auditorit të jashtëm
- 15.4. Rishikimi i efikasitetit të raporteve të auditimit të brendshëm dhe rekomandimeve me menaxhmentin dhe ofrimi i informatave kthyesë të auditimit të brendshëm.
- 15.5. Në fund të cdo viti kalendarik komisioni i auditimit do të vlerësojë punën e auditorit të brendshëm me formë të shkruar, duke mos

përfunduar edhe auditorin e pamvarur të jashtëm në bazë të raporteve të prezentuara nga auditori I brendshëm të ndërmarrjes.

16 . KËRKESAT PËR INFORMACIONE PËR KOMISIONIN E AUDITIMIT.

- 16.1. Për të përmbushur obligimet e veta Komisioni i Auditimit duhet t'i ofrohet informacioni I mëposhtëm, i plotësuar sipas nevojës.
- 16.2. Vlerësimi i rrezikut në ndërmarrje dhe knaqshmërisë së konsumatorëve. (raporton, kryeshefi ekzekutiv)
- Punën e kryera dhe krahasimin me punën e planifikuar.
 - Çështjet kyçe që dalin nga puna e auditimit të brendshëm.
 - Përgjigjja e menaxhmentit dhe rekomandimeve të auditimit.
 - Ndryshimet në planin vjetor të Auditimit;
 - Ndonjë burim, fushë apo vlerësim i çështjeve që ndikojnë në arritjen e objektivave të auditimit;
 - Strategjia mbi auditimin e brendshëm
 - Plani vjetor i auditimit të brendshëm
 - Raportet dhe opinionet nga auditori i brendshëm.
 - Raportet për sigurimin e cilësisë, për sa i përket funksionit të auditimit të brendshëm.
 - Draft pasqyrat financiare dhe shënimet.
 - Raportet mbi çfarëdo ndryshimi në politikën e llogaridhënies.
 - Raporti mbi bashkëpunimin në mes të njësisë së auditimit të Brendshëm dhe Zyrës së auditorit gjeneral.

17 . TË TJERA

- 17.1. Rishiqimi dhe vlerësimi i përshtatshmërisë së rregullore të Komisionit të Auditimit
- 17.2. Konfirmimi një herë në vit që të gjitha përgjegjësitë e parashtruara në këtë rregullore janë plotësuar.
- 17.3. Vlerësimi i performancës së komisionit dhe anëtarëve individual në komision çdo vit.
- 17.4. Vlerësimin e performancës së anëtarëve të komisionit të auditimit e bën kryesuesi i komitetit të auditimit (me shkrim).

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit.

Dëfrim Byqmeti (kryesues i komisionit të auditimit)

Datë: 24.01.2016

